



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr /Br /No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 90 Nr i faq/Bt.str/No.pg 4/2

Data e miratimit 27.06.2023

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 2, nenit 10, paragrafi 2, pika 2.4, nenit 40, nenit 57, paragrafi 1, pika 1.3, dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 27.06.2022 miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510066-00386-1 në Zonën Kadastrale Pastasellë

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/730/23 i datës 8.6.2023 dhe merret vendimi për shpalljen me interes të përgjithshëm publik pjesën e parcelës P-71510066-00386-1 në Zonën Kadastrale Pastasellë, në sipërfaqe prej 600m² (gjashtëqind metra katror) nga sipërfaqja e përgjithshme prej 22005m² (njëzet e dy mijë e pesë metra katror) në vendin e quajtur Seishte, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të PASURLSHTET. E KOSOV. K.K. RAHOVEC SHFRY.EKO. E PYJEVE. RAHOVEC.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës të cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë "Këmbimi i pronës komunale me pronën e institucionit qendror".
3. Autorizohet Kryetari i Komunës që, komform dispozitave ligjore në fuqi, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenin 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Kuvendit,
- Shërbimit të Kuvendit,
- Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,
- MAPL-së, dhe
- Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËSNË RAHOVEC

01Nr.90/23
Datë:27.06.2023

